



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Nr. 114 /2020
Datë: 04.04.2020

Kryeministri i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 94 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 6 (2.1) dhe nenin 11 (1) të Rregullores Nr. 05/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

V E N D I M

1. Znj. Liza Gashi emërohet Zëvendësministre në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.
2. Zëvendësministrja emërohet për mbështetjen e Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe është përgjegjëse për menaxhimin e aktiviteteve në fushat e përcaktuara nga Ministri, si dhe për zëvendësimin e Ministrit kur ai mungon ose kur nuk është në gjendje të kryejë detyrën e tij.
3. Zëvendësministrja, brenda tridhjetë (30) dite nga hyrja në fuqi e këtij Vendimi është e obliguar të bëjë deklarin e pasurisë, në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-050 për deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-228 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-050.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryeministri.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Vendimi i dërgohet:

- Znj. Liza Gashi Zëvendësministre në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Të gjithë Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë Ministrave;
- Shefit të stafit të Kryeministrit;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.